

VENDIM
Nr.727, datë 1.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS GRABIAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Grabian të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Grabian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Grabian

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
5-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
8-10	Shërbim funeral	Në pronësi
11-13,20,26,43	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuar)	Në përdorim
14-19,21,22-25,27-37,40,42,45-47	Infrastrukturë (sheshe)	Në pronësi
48,49,50,117-134,137-184,190-193,194,195	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
51-68	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
75-78	Sisteme të ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

83,84	Ndriçim publik	Në pronësi
85-98	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
99,101,196,197	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
100,108,105,111,115	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive kanale të treta).	Në pronësi